

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**  
**"ALBLOGISTIC" Sh.p.k**

Sot më datë , **26 / Nentor / 2020** , në **Njesia Bashkiake nr 6 Lagja e re, Ish Shkolla e Edukimit prane Repartit Renea, , TIRANE** , është i pranishëm personalisht Ortaku:

**LAVDIJE DATJA** , lindur në Brezhdan, Dibër , më **date 20.02.1961** , identifikuar me Pashaporten **Nr.BJ4142708** dhe Numer Personal **G15220095T** , madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Ortaku i shoqërisë në themelim deklaron me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve që vijnë, hartimin e Statutit të shoqërisë së re të së drejtës shqiptare **"ALBLOGISTIC" Sh.p.k** mbi bazën e ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe hartojnë këtë Statut si vijon:

**Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë**

Emri i shoqërisë është **"ALBLOGISTIC" Sh.p.k**. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin **"ALBLOGISTIC" Sh.p.k** (në vijim "Shoqëria").

**Neni 2 Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: **Njesia Bashkiake nr 6 Lagja e re, Ish Shkolla e Edukimit prane Repartit Renea, , TIRANE** Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë, si dhe mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3 Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është pa afat të caktuar.

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga momenti regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.





#### **Neni 4 Objekti i Shoqërisë**

##### **Shoqëria ka për objekt:**

Tregti me shumice dhe pakice e artikujve ushqimorë dhe industriale si dhe ambalazhim, paketim dhe transportim . Transport mallrash për vetë dhe për të tretë.

Import – eksport të mallrave të ndryshëm ushqimorë dhe industriale .

#### **Neni 5 Kapitali i Shoqërisë**

**5.1** Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100 (njëqind) Lekë . Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 ( një ) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku :

- **LAVDIJE DATJA** , zotërues i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100 (Njëqind) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të rritet dhe është totalisht i paguar dhe nënshkruar nga ortakët.

**5.2** Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

**5.3** Kuotat e kapitalit derdhen nga ortakët në Bankë, në llogarinet bankare të Shoqërisë dhe derdhet e kuotave regjistrohen në librin e llogarisë së Shoqërisë.

**5.4** Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë të nënshkruara nga ortakët e Shoqërisë.

**5.5** Ortakët kanë të drejtë të tërheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të Shoqërisë, në rast se Shoqëria nuk regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit , brenda 6 (gjashtë) muaj nga data e depozitimit të fondeve.

#### **Neni 6 Transferimi i kuotave me akt midis të gjallëve dhe me trashëgimi**

**6.1** Transferimi i kuotave është i vlefshëm si me akt midis të gjallëve si dhe me trashëgimi ndaj ortakëve të Shoqërisë, vetëm në rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni.

**6.2** Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues më parë duhet të bëjë një ofertë, ortakëve të tjerë me letër rekomande, ku përcakton cmimin e kërkuar për shitjen e kuotave të tij. Në këtë rast secili nga ortakët në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin themeltar ka të drejtën e parablerjes.

**6.3** Në rast mosmarrëveshjes mbi cmimin e kërkuar, ky i fundit do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i cili miratohet me shumicë të thjeshtë nga asambleja e ortakëve i cili do të përcaktojë cmimin e shitjes duke u bazuar mbi vlerën reale të kuotave.

**6.4** Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, ky i fundit me shpenzimet e secilës palë, do të zgjidhet nga gjykata ku ka selinë shoqëria dhe me kërkesë të palës së interesuar.

**6.5** Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislati shqiptar.



**6.6** Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, shitësi por edhe blerësi kanë të drejtë të tërhiqen, përkatësisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të personit që tërhiqet.

**6.7** E drejta e parablerjes që nuk është ushtruar nga ana e njërit prej ortakëve i kalon ortakëve të tjerë, gjithmonë në përputhje me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

**6.8** Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit me akt të shkruar ortakëve blerës brenda 3 muajve nga marrja e komunikimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël brenda afatit prej 60 ditë nga dita e vlerësimit.

**6.9** E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe tre mujore nga data e komunikimit të ofertës ose brenda 60 ditëve nga data e fiksimit të cmimit nga ana e ekspertit kontabël që është emëruar. Pasi kanë kaluar afatët e mësipërme, shitësi ka të drejtën t'i transferojë tëk të tretët kuotat e tij.

**6.10** Transferimi i kuotave për shkak trashëgimie ndaj trashëgimtarëve të të ndjerit është i kufizuar me dhënien e miratimit e ortakëve të mbledhur në asamblenë e përgjithshme. Në rast kundërshtimi të ortakëve për transferimin e kuotave drejt trashëgimtarëve të të ndjerit, cmimi i shitjes do të caktohet sipas procedurave për transferimin me akt midis të gjallëve si me sipër.

#### **Neni 7**

Fitimet e Shoqërisë i takojne ortakeve të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

#### **Neni 8**

Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurine e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, matëriale ose jo-matëriale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet të akumuluar, tëk të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gezon të drejta sikundër cdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 9**

Shoqëria, vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

#### **Neni 10 Drejtimi i Shoqërisë**

Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve, të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuara në këtë statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi në aktin e themelimit dhe në statut;
2. miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarisë së dministrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;
3. emërimi e shkarkimi i administratorëve qofshin ortakë ose jo dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
4. miratimin e kredive dhe të garancive;



5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
10. vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose të agjencive të Shoqërisë;
11. vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e Shoqërisë;
12. vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria;
13. vendimin për emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar apo të konsulentëve të tjere, qoftë persona fizike qoftë juridike;
14. vendimin për ndarjen e kuotave dhe për anulimin tyre;
15. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
17. vendimin në shitjet e kuotave të Shoqërisë;
18. vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e cdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

#### **Neni 11**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike email e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

#### **Neni 12**

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja apo votimi në asamblenë e përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këto raste është e nevojshme prania e Noterit. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Asambleja e përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri.

Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamblenë e zakonshme dhe/ose jashtëzakonshme është ai i parashikuar në nenet 86, 87 të ligjit 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" .





### Neni 13

Administratori i parë dhe i vetëm i shoqërisë është:

**LAVDIJE DATJA**, lindur në Brezhdan, Dibër, më date **20.02.1961**, identifikuar me Pashaporten **Nr.BJ4142708** dhe Numer Personal **G15220095T**, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cila ushtron të gjitha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Administratori i vetëm emërohet për një afat 5 (pesë) vjecar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtë riemërimi në qoftë se do të emërohet sërish administrator nga asambleja e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për shkarkimin e tij. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpara mbarimit të mandatit, me njoftim, dhënie llogarie dhe aprovim përpara asamblesë së përgjithshme, sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të cfarëdo kombësie dhe të jashtëm për shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo më shumë administratorëve në fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrorë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ato do të jetë individualisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për administratorin dhe do t'i komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimet nga ai të kryera. Administratori ose administratorët kanë detyrimin të japin llogari përpara asamblesë së përgjithshme të ortakëve, për aktivitetin e tyre, cdo herë që i kërkohet nga ortakët.

### Neni 14

Administratori i vetëm kryen detyrat e përcaktuara nga ortakët e Shoqërisë në këtë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndër këto përshihen detyrat e listuara me poshtë.

1. Të veproje dhe të nënshkruaje në emër të shoqërisë.
2. Të hartojë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financiar, që do të miratohet në asamblenë e përgjithshme.
3. Të marrë vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënien e garancive.
4. Të përpunojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e përgjithshme raportë për ecurinë e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes së aktivitetit financiar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
5. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
6. Administratori (apo administratorët në rast se do të emërohet ndonjë tjetër në vijim) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ecurisë së aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
7. Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
8. Të përfaqësojë shoqërinë tregtare.



9. Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrektësi dhe saktësi.
10. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
11. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
12. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë.
13. Pranimet në punë, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna pasi të jetë marrë më parë aprovimi nga asambleja e ortakëve.
14. Të emërojë financier e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiarë tre-mujorë, gajsthtë-mujorë dhe vjetorë, për aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
15. Të mirë administrojë Shoqërinë.
16. Të lidhë marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
17. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
18. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
19. Të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
20. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për shoqërinë.
21. Të kryejë të gjitha veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
22. Administratori ka të drejtë dhe detyrë të thërrasë asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në nenet 11 dhe 12 të këtij statuti dhe të ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht në statut.

#### **Neni 15 Të drejtat e Shoqërisë**

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimtari në baze të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të sigurojë pasurinë e vet;
3. të marreë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
4. të përfitojë nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
5. të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
6. të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;
7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

#### **Neni 16 Detyrat e Shoqërisë**

Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;





5. të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
6. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

#### **Neni 17 Marrëdhëniet ekonomike – financiare të Shoqërisë**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

#### **Neni 18**

Në selinë e Shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

#### **Neni 19**

Viti financiar fillon çdo vit më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

#### **Neni 20**

Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në LEKE dhe/ose EURO dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.

#### **Neni 21**

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, le mënjanë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.

#### **Neni 22 Dispozita të veçanta**

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit ne fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

#### **Neni 23 Shndërrimi**

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të tipeve të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakëve themelues sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

#### **Neni 24 Prishja e Shoqërisë**

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 dhe për arsyet si më poshtë:

- me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit të Shoqërisë;

Në këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen



e pasurisë së Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizikë e juridikë, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshëm, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të Shoqërisë që të derdhe tërësisht kuotat që u takojnë.

#### **Neni 25 Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni**

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe Administratorit do t'i nënshtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

#### **Neni 26**


Ky statut përpilohet në 2 ( dy ) ekzemplarë në gjuhën shqipe , të nënshkruara rregullisht nga Ortaku.

Ngarkohet administratori **LAVDIJE DATJA** , lindur në Brezhdan, Dibër , më date **20.02.1961** , identifikuar me Pashaporten **Nr.BJ4142708** dhe Numer Personal **G15220095T** për të kryer të gjitha procedurat pranë QKB-së për rregjistrimin e shoqërisë.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

**"ALBLOGISTIC" Sh.p.k**

**LAVDIJE DATJA**



*Tiranë më 26 /Nentor/2020*

